STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

**Për Njoftim të Menjëhershëm:** 9 nëntor 2012

**GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON NDIHMEN PER HUATE STUDENTORE PER BANORET E NJU JORKUT TE PREKUR NGA URAGANI SENDI (SANDY)**

***Banorët e Nju Jorkut në qarqet e katastrofës kanë të drejtën e një periudhë falje prej 90 ditësh për të paguar huatë***

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) udhëzoi sot Korporatën e Shërbimeve të Arsimit të Lartë të Shtetit të Nju Jorkut (HESC) që të japë ndihmë të përkohëshme për huatë studentore për banorët e Nju Jorkut që u prekën nga Uragani Sendi (Sandy). Nëse e kërkojnë, banorët e Nju Jorkut në qarqet e Bronksit (Bronx), Kings, Nasau (Nassau), Nju Jork (New York), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklend Rockland), Safolk (Suffolk) dhe Uestçester (Westchester)kanë tani të drejtë që të marrin një periudhë falje prej 90 ditësh, nga 27 tetori 2012 deri në 25 janar 2013, në mënyrë që të ripaguajnë pagesat e huasë studentore të tyre. Të gjithë anëtarët e ushtrisë që janë thirrur për të ndihmuar pas Uraganit Sendi (Sandy) gjithashtu do të kenë këtë të drejtë.

"Jemi duke punuar që t'u sigurojmë banorëve të Nju Jorkut që po rimëkëmben nga Uragani Sendi (Sandy) sa më shumë ndihmë dhe mbështetje që të jetë e mundur," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Atyre që humbën shtëpitë ose që janë ende pa energji nuk duhet t'u vihet barra e shqetësimit tjetër se janë të vonuar në pagesat e huave të tyre studentore. Periudha e faljes që po sigurojmë do t'ju japë këtyre banorëve të Nju Jorkut një farë hapësirë që të përqëndrohen në rindërtimin dhe rifillimin e jetës së tyre pas stuhisë."

Përveç pezullimit të përpjekjeve të mbledhjes, veprime të tjera për të ndihmuar huamarrësit studentorë të prekur do të përfshijnë pezullimin ose heqjen e njoftimeve të kundravajtjes ose mospagesës të bëra nga HESC tek agjencitë e njoftimit të kredisë, pezullimin e referimeve për marrjen nga paga administrative dhe pezullimin e telefonatave për mbledhjen për huamarrësit studentorë federalë në Nju Jork, Nju Xhërsi (New Jersey) dhe Konetikat (Connecticut), që janë në kundravajtje në pagesat e huave të tyre studentore federale.

"Më shumë se 80 përqind e huamarrësve tanë me hua studentore në kundravajtje ose mospagesë banojnë në dhe përreth zonës metropolitane të Qytetit të Nju Jorkut," tha Elsa Magi (Elsa Magee), Presidente e Përkohëshme e HESC-it. "Ky është një element tjetër i përpjekjes së përgjithshme të Guvernatorit për të ndihmuar ata që janë ndikuar negativisht nga Sendi (Sandy)."

Albanian

Huamarrësit duhet të kontaktojnë HESC për të kërkuar një pezullim të përkohëshëm duke telefonuar në 1-866-991-HESC (4372) ose duke dërguar një e-mail në Dept736@hesc.ny.gov. Një opsion i caktuar është shtuar në numrin telefonik falas për viktimat e Sendit (Sandy).

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418